



AGROKREDIT

SHTOJCA NR.1

e Dokumenteve Standarte të Tenderit te procedures se prokurimit me objekt :
“Shërbimi i mirëmbajtjes dhe riparimit të automjeteve ”– **Marreveshje**
Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të
përcaktuara - me afat 29 muaj.



Në mbështetje të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, neni 42, pika 2, Autoriteti Kontraktor, Agrokredit sh.a, bazuar ne rekomandimet e derguara nga Agjencia e Prokurimit Publik, bën ndryshimet e mëposhtme të dokumenteve të tenderit, përmes hartimit të kësaj shtojce, e cila vihet në dispozicion në rrugë elektronike të gjithë operatorëve ekonomikë të interesuar.

Në Dokumentet Standarte të Tenderit te procedures se prokurimit REF-66311-07-22-2020, me objekt : “Shërbimi i mirëmbajtjes dhe riparimit të automjeteve ”– **Marreveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 29 muaj**, bëhet ndryshimi si me poshte:

1. Shtojca 7, “2. KRITERET E VEÇANTA TE KUALIFIKIMIT”, behet ndryshimi i meposhtem:

Pika 2.3.4 ishte:

2.3.4 Drejtuesi teknik i operatorit ekonomik ofertues, servis automjeteve, duhet të jetë inxhinier mekanik, i profilit transport dhe me kohë të plotë pune pranë ofertuesit, i cili duhet te disponoje kualifikimet e meposhtme:

- Diplomën përkatëse
- Dëshmi Aftesie Profesionale te veprimtarise se autoriparimit (referuar Ligjit Nr.9573, dt.03/07/2006) per nen kategorite, si vijon:
 - A- Riparim dhe mirembajtje e pjeseve mekanike dhe te motorrit
 - B- Riparim dhe mirembajtje karrocierie

PIKA 2.3.4 BEHET:

2.3.4 Drejtuesi teknik i operatorit ekonomik ofertues, servis automjeteve, duhet jetë inxhinier mekanik **ose teknik, mekanik transporti** dhe me kohë të plotë pune pranë ofertuesit, per plotesimin e ketij kriteri duhet te paraqese kualifikimet e meposhtme:

- Diplomën përkatëse
- Dëshmi Aftesie Profesionale te veprimtarise se autoriparimit (referuar Ligjit Nr.9573, dt.03/07/2006) per nen kategorite, si vijon:
 - A- Riparim dhe mirembajtje e pjeseve mekanike dhe te motorrit
 - B- Riparim dhe mirembajtje karrocierie

2. Pika 3.1, seksioni 3 ne UDHËZIME PËR OPERATORËT EKONOMIKË, NDRYSHON SI POSHTE VIJON:

“3.1 Kriteret e përzgjedhjes

(Opsioni 1) Çmimi më i ulët i ofertës së kualifikuar.

Kontrata do t’i akordohet atij Ofertuesi që ka ofruar çmimin më ulët të ofertës.



(Opsioni 2) Oferta ekonomikisht më e favorshme.

Për kriteret vlerësuese duhet përcaktuar qartë pesha specifike e secilit kriter dmth sa pikë do të ketë çdo kriter dhe si do të llogariten pikët për ofertuesit e njëpasnjëshëm.

Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të cmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100.

Formula me të cilën do të llogariten pikët e ofertuesve në këtë rast është:

$$Po = Pk1 + Pk2 + Pk3 + \dots$$

Ku:

Po - janë pikët totale të ofertës së vlerësuar

Pk1/Pk2/Pk3/... - janë pikët për çdo kriter të vlerësuar

Pikët për çdo kriter përlllogariten sipas formulës:

$$Pk1 = Vmin1 \times Pmax1 / Ok1$$

Pk1 _____ Pikët e kriterit që vlerësohet

Vmin k1 _____ Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet

Pmaxk1 _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

Ok1 _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Sqarim

Si kriter vlerësimi duhet të përzgjidhet vetëm njëri prej opsioneve . Plotësimi i të dy opsioneve e bën procedurën të pavlefshme.

Në rastin e prokurimit të marrëveshjes kuadër, kur objekt i kësaj marrëveshje janë biletat e transportit ajror ndërkombëtar, në vend të çmimit do të përdoret marzhi i fitimit i shprehur në përqindje.”

3. Afati kohor për dorëzimin dhe hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje, ndryshojnë si vijon:

Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje ishte:

Data: 03/08/2020 (dd/mm/vvvv) Ora: 10:00

Vendi: www.app.gov.al

Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje behet:

Data: 10/08/2020; Ora: 10:00

Vendi: www.app.gov.al

Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje ishte:

Data: **03/08/2020** (dd/mm/vvvv) **Ora: 10:00**

Vendi: www.app.gov.al



AGROKREDIT

Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje behet:

Data: 10/08/2020; Ora: 10:00

Vendi: www.app.gov.al

**TE GJITHA KUSHTET E TJERA TË DOKUMENTIT TË TENDERIT
MBETEN TË PANDRYSHUARA.**